



This programme is funded  
by the European Union



Gender Alliance for Development Center  
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



# Monitorim i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore

## Bashkia Elbasan

### VITI 2019

## Tabela e Përmbajtjes

MONITORIMI I QËLLIMIT TË III-TË STRATEGJIK TË STRATEGJISË KOMBËTARE DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2016-2020.....	3
GJETJET KRYESORE.....	3
TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME RAPORTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE NË BASHKINË ELBASAN .....	4
REZULTATET E MONITORIMIT – VITI 2019 .....	6
OBJEKTIVI 3.1 NDËRGJEGJËSIMI I SHOQËRISË PËR TË MOS PRANUAR DHE PËR TË MOS TOLERUAR USHTRIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE. ....	6
OBJEKTIVI 3.2: FUQIZIMI I MEKANIZMAVE TË REFERIMIT SI DHE SHTIMI/PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË SPECIALIZUARA PËR MBROJTJEN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.....	15
OBJEKTIVI 3.3: NDËSHKIMI I DHUNUESVE DHE DHËNIA E MUNDËSISË PËR REHABILITIMIN ETYRE, PËRMES PROGRAMEVE TË SPECIALIZUARA. ....	20
REKOMANDIME.....	21

## Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020

**Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2019.**

### Gjetjet kryesore

- Përgjatë vitit 2019, pranë komisarariatit qendër në bashkinë Elbasan janë evidentuar 194 raste të dhunës në familje, nga të cilat 152 viktima ishin gra/vajza. 131 ishin kërkesat për Urdhër Mbrojtje të paraqitura dhe 4 ishin kërkesat për rastet e shkeljes së U.M.
- Përgjatë periudhës janar – dhjetor 2019 nga Mekanizmi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunë në familje në Bashkinë Elbasan janë identifikuar dhe mbështetur me shërbime 134 raste të dhunës në marrëdhëniet familjare.
- Përgjatë periudhës janar – dhjetor 2019, pranë gjykatës së rrethit Gjyqësor Elbasan u paraqitën 218 raste të reja kërkesa për urdhra mbrojtje.
- Pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan janë regjistruar në total (130/a1,2,3,4) 109 procedime penale të reja .
- Numri i aktiviteteve të koordinuara e të realizuara nga Bashkia përgjatë vitit 2019 ishte 48, ndërkohë që në bashkëpunim me aktorët lokale publikë e jo publikë, numri i këtyre aktiviteteve përgjatë vitit 2019 ishte 80 të tilla me pjesëmarrjen e 3200 personave.
- Për periudhën Shtator 2018 – Shtator 2020 , kjo bashki është bashkëfinancuese në shumën 25.000 \$, me PNUD në kuadër të Programit Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD) që financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, për financim të përbashkët të OJF-ve brenda dhe jashtë Elbasanit.
- Me ndihmë ekonomike për shkak të UM , gratë kryefamiljare/ vajzat nëna janë mbështetur edhe me bonus qeraje në 16 raste, pagesë e çerdhes për fëmijët në 9 raste (të përfshira në UM).
- Bashkia Elbasan ka qenë pjesëmarrëse dhe bashkëpunuese në aktivitetet e organizuara nga Forumi i Gruas me Komunitetet Fetare. Konkretisht përgjatë 2019-ës janë organizuar 7 aktivitete të tilla.
- Koordinatorja Vendore pranë bashkisë Elbasan ndan me anëtarët e MKR-së raportet dhe dokumentat zyrtare pas çdo mbledhje të përmbujshme të GTN-së.
- Përgjatë vitit 2019, numri i rasteve të trajtuara me sukses nga Mekanizmi i Referimit pranë Bashkisë Elbasan ishte 60 rasteve të viktimave të dhunës në familje.
- Me Zyren Rajonale të Punësimit Elbasan, ka bashkëpunim të ndërsjelltë dhe konkretisht janë arritur të punësohen 12 raste të grave me probleme dhune të pajisura me UMM/UM.
- Përgjatë vitit 2019 u realizuan 19 mbledhje të GTN-së dhe një mbledhje e Komitetit Drejtues.

- Rehabilitimi i dhunuesve dhe personave të dënuar njësoj si në dy vitet e fundit (2017 – 2018) zhvillohet nga Shoqata Tjetër Vizion e cila ofron shërbimin për këshillimin psiko-social të burrave dhe djemve të dhunshëm në funksion të ri-edukimit të dhunës në marrëdhëniet familjare. Edhe pse në çdo rast dhunuesit janë këshilluar nga nëpunësi gjinor të paraqiten pranë këtij shërbimi, për vitin 2019 janë trajtuar vetëm 11 raste të burrave dhunues
- Zyra e Përmbarrimit ka egzekutuar 1 rast me objekt “Urdhër Mbrojtje” për vitin 2019 ndërkohë që të mbartura janë 4 çështje;

## Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje në Bashkinë Elbasan

### Të dhëna statistikore nga Drejtoria e Policisë Elbasan<sup>1</sup>

Përgjatë vitit 2019, janë evidentuar 194 raste të dhunës në familje, nga të cilat 152 viktima ishin gra/vajza. Ndërkohë që numri i rasteve të veprës penale “dhunë në familje” neni 130/a për vitin 2019 ishte 53 dhe u arrestuan 25 autorë. Numri i të dëmtuarve është më i madh se sa rastet e evidentuara, pasi në një vepër penale apo kërkesë padi për Urdhër Mbrojtje mund të jenë më shumë se një i dëmtuar

131 ishin kërkesat për Urdhër Mbrojtje të paraqitura pranë komisariatit qendër pranë kësaj bashkie dhe 4 ishin kërkesat për rastet e shkeljes së U.M. Ndërkohë që detaje më të hollësishme në lidhje me të dhënat zyrtare paraqiten në tabelën si vijon më poshtë.

**Tabela 1. Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore Policise Bashkisë Elbasan**

Përshkrimi	Kom. Elbasan
<b>Evidentuar</b>	<b>194</b>
<b>Të dëmtuar gjithsej</b>	<b>199</b>
<b>Prej tyre gra/vajza</b>	<b>152</b>
<b>Kërkesë për U.Mbrojtje</b>	<b>131</b>
<b>Shkelje U.Mbrojtjes</b>	<b>4</b>
<b>V. P. Neni 130/a</b>	<b>53</b>
<b>Arrest. për 130/a</b>	<b>25</b>
<b>Ndaluar për 130/a</b>	<b>0</b>

<sup>1</sup> Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

<b>Gjendje të Lirë për 130/a</b>	<b>30</b>
<b>Në kërkim për 130/a</b>	<b>2</b>
<b>Autorë të vetëvrarë</b>	<b>0</b>

*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit*

Mekanizmi i referimit të rasteve të dhunës në familje në bashkinë Elbasan mbledhet në mënyrë periodike për adresimin e çështjeve të barazisë gjinore dhe dhunës në familje.

Përgjatë periudhës janar – dhjetor 2019 nga Mekanizmi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunë në familje në Bashkinë Elbasan janë identifikuar dhe mbështetur me shërbime 134 raste të dhunës në marrëdhëniet familjare. Nga të cilet 82 raste të reja me UMM/UM, 13 raste të mbartura (kohezgjatja e UM) nga 2018 (në vazhdimësi UM), 31 raste të mbështetura me shërbimeve për të parandaluar dhunën në familje.

<b>Indikatorët</b>	<b>Periudha janar-dhjetor</b>
<b>Nr.i rasteve të dhunës në familje (total)</b>	<b>134</b>
Nr.i rasteve me UMM/UM	82
Nr.i rasteve pa UM	31
Nr. i rasteve të rrëzimit të kërkesë-padisë	8
Nr.i rasteve të mbartura nga viti 2018	13
Meshkuj	9
Femra	125
Romë	6
Egjiptianë	29
Maxho	100
Fëmijë (të përfshirë në UM)	43
Fëmijë/femra	18

*Burimi: Bashkia Elbasan*

### **Statistika nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Elbasan<sup>2</sup>**

Përgjatë periudhës janar – dhjetor 2019, pranë gjykatës së rrethit Gjyqësor Elbasan u paraqitën 218 raste të reja kërkesa për Urdhra Mbrojtje dhe Urdhra të Menjëhershëm Mbrojtje. Ndër to, kjo gjykatë pranoi 84 raste, hodhi poshtë 63 të tilla dhe pushoi 71 çështje.

Ndërkohë që për veprën penale të dhunës në familje sipas nenit 130/a përgjatë vitit 2019 u paraqitën 51 raste të reja, të cilat së bashku me rastet e mbartura nga një vit më parë kapën shifrën e 61 rasteve. Nga të gjitha rastet në total, 48 u deklaruan të fajshëm dhe u gjykuan nga gjykata e rrethit gjyqësor Elbasan.

### **Statistika nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan<sup>3</sup>**

<sup>2</sup> Burimi: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan

<sup>3</sup> Burimi: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan

Lidhur me procedimet penale te regjistruara per janar – dhjetor 2019 për veprat penale të dhunës në familje parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan pasqyrohen të detajuara si vijon:

Janë regjistruar në total (130/a1,2,3,4) 109 procedime penale me 16 persona nën hetim, 57 të pandehur dhe 27 persona të arrestuar; Është kërkuar pushimi i procedimit për 10 procedime penale 21 procedime sipas nenit 130/a1,2,3,4

Janë dërguar për gjykim 66 procedime penale, me 75 të pandehur dhe 26 persona të arrestuar.

## **Rezultatet e Monitorimit – Viti 2019**

### **Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.**

Bashkia Elbasan në bashkëpunim me institucione publike pjesë e mekanizmit referues ka organizuar fushata ndërgjegjësimi të komunitetit rreth dhunës me bazë gjinore dhe përpjekjet që duhen bërë për ta parandaluar këtë fenomen.

Bashkëpunimi ndërsektorial i bashkisë Elbasan me aktorët lokalë është fokusuar edhe në drejtim të sensibilizimit të komunitetit mbi çështje që kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave të grave/vajzave, fëmijëve, komunitetit rom etj.

OSHC-të bashkëkoordinuese në territorin e bashkisë Elbasan për vitin 2019 janë:

1. “Forumi i Gruas Elbasan”
2. “Tjetër Vizion”,
3. “World Vizion”
4. “A2B”
5. “Romano Sezzi”
6. “Gruaja për zhvillim kulturor” etj.

Bashkia Elbasan ka të nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me disa OJF, si me “Forumi i Gruas Elbasan”, “Tjetër Vizion”, “World Vizion”, “A2B”, “Romano Sezzi” Forumin e OSHC-ve. Ka gjithashtu marrëveshje edhe me organizata të tjera lokale, kombëtare që realizojnë projekte në territorin e bashkisë Elbasan.

Për periudhën janar - dhjetor 2019, Bashkia Elbasan në bashkëpunim me OJF-të si: FGE, Tjetër Vizion, World Vizion, A2B, “Romano Sezzi” si dhe institucione publike pjesë e mekanizmit referues ka realizuar disa fushata ndërgjegjësuere si:

1. Fushata lokale për Adresimin e Çështjeve të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore;
2. Fushata 16 Ditët e Aktivizmit për Barazinë Gjinore dhe kundër dhunës në familje;
3. Fushata ndërgjegjësuere në lidhje me të drejtat dhe fuqizimin e grave e vajzave.

#### 4. Fushatë ndërgjegjësuese mbi të drejtat e fëmijëve Janar - Nëntor 2019

Numri i aktiviteteve të koordinuara e të realizuara nga Bashkia përgjatë vitit 2019 ishte 48 aktivitete, ndërkohë që në bashkëpunim me aktorët lokale publikë e jo publikë, numri i këtyre aktiviteteve përgjatë vitit 2019 ishte 80 të tilla. Gjithashtu kjo bashki ka realizuar aktivitetet ndërgjegjësues me shoqatën World Vizion.; është përfshirë në realizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese për 8 Marsin me FGE-në dhe OJF të tjera.

Rreth 3200 persona në total janë përfshirë në këto aktivitete. Target grupet kanë qenë gra/vajza, burra/djem,të rinj/të reja, nxënës shkolle dhe studentë.

Zakonisht organizohen rreth 140 aktivitete ndërgjegjësuese, si forume në komunitet me burra/gra, vajza/djem, në zonat rurale dhe urbane, takime me nxënës të shkollave të mesme e 9/vjeçare, takime e leksione të hapura me studentë, sesione informuese me SPZ-te, mjekët e familjes, administratorët sociale, prindër e fëmijë, grupmosha e tretë, sesione fuqizuese me gratë e mbijetuara nga DHF, me komunitetet e ndryshme fetare etj.

Në kuadër të rritjes së kapaciteteve të punonjësve në Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan, për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare u organizua më datë 31.5.2019 takimi informues me administratorët shoqërorë dhe punonjësit socialë të 12 njësive administrative të kësaj bashkie.

Gjithashtu, janë organizuar në bashkëpunim me Forumin e Gruas Elbasan, sesione për ngritje kapaciteti me administratorët social, infermierë dhe SPZ në të 6 njësitë administrative meqënëse janë personat e parë që presin dhe identifikojnë një rast dhune.

Bashkia Elbasan ka bashkëpunim të frytshëm me organizata ndërkombëtare, si PNUD, UN Women, USAID, OSCE etj.

Për periudhën Shtator 2018 – Shtator 2020 , kjo bashki është bashkëfinancuese në shumën 25.000 \$, me PNUD në kuadër të Programit Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD) që financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, për financim të përbashkët të OJF-ve brenda dhe jashtë Elbasanit.

Konkretisht Bashkia ka kontribuar financiarisht në realizimin e projektit ”Fuqizimi dhe ri-integrimi i grave/vajzave të mbijetuara te DHBGJ/DHF në bashkinë Elbasan”. Ky projekt është zbatuar nga Forumi i Gruas Elbasan në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan. Gjithashtu bashkia ka vënë në dispozicion burimet e veta njerëzore dhe në natyrë.

Bashkia paguan nga buxheti i saj pagën e Nepunëses gjinore dhe koordinatorë e dhunës në familje, në shumën vjetore 696.000 lekë (58.000 leke/muaj).

Me ndihmë ekonomike për shkak të UM , gratë kryefamiljare/ vajzat nëna janë mbështetur edhe me bonus qeraje në 16 raste, pagesë e çerdhes për fëmijët në 9 raste (të përfshira në UM).

Për periudhën e vitit 2019 Bashkia alokoi një fond prej 100.000 lekësh për pagesë qeraje të rasteve emergjente të grave me probleme dhune e social-ekonomike (6 raste gra të dhunuara dhe 5 fëmijë)

Ndërkoi që për periudhën Tetor 2019 -30 Shtator 2020, Bashkia Elbasan ka parashikuar një fond prej 1.500.000 lekë për shërbimet sociale në kuadër të projektit me "Fondin Social" të Ministrisë së Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale.

Bashkia e Elbasanit ka krijuar një model të qëndrueshëm e të ndjeshëm gjinor të buxhetimit me pjesëmarrje gjinore fillimisht me mbështetjen nga UN Woman, proces të cilin e ka realizuar prej 7 vitesh. Edhe për këto vit u realizua gjatë muajit Tetor 2019 nga vetë Bashkia.

**Tabela 2. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre**

<b>Nr</b>	<b>Data</b>	<b>Vendi</b>	<b>Pershkrimi I aktivitetit</b>	<b>Institucioni</b>
1.	12.02.2019	Shkolla e Mesme "Anastas Cakalli" Nj.A. Shirgjan	Ndërgjegjësimi i të rinjve (vajza/djem) në lidhje me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje.	Nëpunëse Gjinore/Bashkia Elbasan; N/Specialist i Policimit në komunitet; Edukatorë Shkolle; Punonjëse e Shërbimit Psikosocial; Punonjës Social në Nj.A. Shirgjan
2	20.02.2019	Shkolla e mesme "Kostandin Shpataraku" NJ.A.Gjinar	Takim ndërgjegjësues me djem dhe vajza për të folur mbi bullizmin, si një formë dhune e përhapur tek të rinjtë.	Forumi i Gruas Elbasan Bashkia Elbasan
3	21.02.2019	Shkolla e mesme "Kostandin Shpataraku" NJ.A.Gjinar	Takim ndërgjegjësues me djem dhe vajza mbi mbi ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme, martesat e hershme dhe mentalitetin në zonat rurale.	Forumi i Gruas Elbasan Bashkia Elbasan
4	22.02.2019	Shkolla e mesme "Kostandin Shpataraku" NJ.A.Gjinar	Takim ndërgjegjësues me djem dhe vajza mbi ndërtim Takim ndërgjegjësues me djem dhe vajza mbi mbi ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme, martesat e hershme dhe mentalitetin në zonat rurale.	Forumi i Gruas Elbasan Bashkia Elbasan
5	26.02.2019	Shkolla e mesme "Anastas Cakalli" Kuqan, NJ.A	Takim ndërgjegjësues me djem dhe vajza mbi mbi ndërtimin e marrëdhënieve të	Forumi i Gruas Elbasan Bashkia Elbasan



		Shirgjan.	shëndetshme, martesat e hershme dhe mentalitetin në zonat rurale.	
6	27.02.2019	Shkolla e mesme "Anastas Cakalli" Kuqan, NJ.A Shirgjan.	Takim ndërgjegjësues me djem dhe vajza mbi mbi ndërtimin e marëdhënieve të shëndetshme, martesat e hershme dhe mentalitetin në zonat rurale.	Forumi i Gruas Elbasan Bashkia Elbasan
7	28.02.2019	Shkolla e mesme "Anastas Cakalli" Kuqan, NJ.A Shirgjan.	Takim ndërgjegjësues me djem dhe vajza mbi mbi ndërtimin e marëdhënieve të shëndetshme, martesat e hershme dhe mentalitetin në zonat rurale.	Forumi i Gruas Elbasan Bashkia Elbasan
8	06.03.2019	Universitetit "Aleksander Xhuvani" Elbasan.	Leksion i hapur ndërgjegjësues me studentë të Departamentit të Gjuhës Angleze dhe Gjermane për trajtimin e çështjeve gjinore të grave dhe vajzave në media, në kuadër të 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Grave.	Forumi i Gruas Elbasan Departamenti I Gjuhës Angleze dhe Gjermane në UE
9	08.03.2019	Në sheshin kryesor të qytetit Elbasan	Aktivitetet ndërgjegjësues me vajza dhe gra dhe me pjesëmarrjen e Prefektit të Qarkut Z. Gledian Llatja. Aktiviteti "Të Drejta për 8 Mars" u fokusua tek të drejtat e grave, veçanërisht e drejta pronësore.	Forumi i Gruas Elbasan Bashkia Elbasan
10	19.03.2018	Shkolla e Mesme "SaliBallkoci" Njesia Administrative LabinotFushe	Ndërgjegjësimi i të rinjve (vajza/djem) në lidhje me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje.	- Nëpunëse Gjinore/BashkiaElbasan -N/Specialist I Policimit në Komunitet/Edukator Shkolle -Punonjëse e Shërbimit Psikosocial -Punonjës social në Nj.A. LabinotFushe
11	20.03.2019	Klasa e IX e shkollës 9 vjeçare "Sule Harri"	Takim informues me temë "Të drejtat e fëmijës, dhuna me bazë gjinore dhe trafikimi i qënieve njerëzore"	Shoqata Tjetër Vizion në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan

13	21.03.2019	Klasa e IX e shkollës 9 vjeçare "Qamil Guranjaku"	Takim informues me temë "Të drejtat e fëmijës, dhuna me bazë gjinore dhe trafikimi i qënieve njerëzore"	Shoqata Tjetër Vizion në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan
14	26.03.2019	Shkolla e Mesme "Fiqiri Balteza" Nj. A. Paper	Ndërgjegjësimi i të rinjve (vajza/djem) në lidhje me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje.	- Nëpunëse Gjinore/Bashkia Elbasan -N/Specialist I Policimit në Komunitet/Edukator Shkolle -Punonjëse e Shërbimit Psikosocial -Punonjës social në Nj.A. Paper
15	31.03.2019	Shkolla e Mesme "Kostandin Shpataraku" Nj.A. Gjinar	Ndërgjegjësimi i të rinjve (vajza/djem) në lidhje me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje.	- Nëpunëse Gjinore/Bashkia Elbasan -N/Specialist I Policimit në Komunitet/Edukator Shkolle -Punonjëse e Shërbimit Psikosocial -Punonjës social në Nj.A. Gjinar
16	03.04.2019	NJ. A. Labinot - Fushë Elbasan	Forum në komunitet me burra dhe gra mbi barazinë gjinore, dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore.	Forumi i Gruas Elbasan Bashkia Elbasan
17	04.04.2019	Shkolla e bashkuar "Sami Ballkoci" NJ. A. Labinot - Fushë Elbasan	Takim ndërgjegjësues me të rinjtë, djem dhe vajza mbi dhunën mes të rinjve, dhunën në familje dhe komunikimin e shëndetshëm në shkollat tona.	Forumi i Gruas Elbasan Bashkia Elbasan
18	09.04.2019	Klasa e IX e shkollës 9 vjeçare "Fejzulla Guranjaku".	Takim informues me temë "Të drejtat e fëmijës, dhuna me bazë gjinore dhe trafikimi i qënieve njerëzore"	Shoqata Tjetër Vizion në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan
19	10.04.2019	Shkolla e bashkuar "Fiqiri Balteza" NJ.A Paper, Elbasan.	Takim ndërgjegjësues me të rinjtë djem dhe vajza mbi dhunën mes të rinjve, dhunën në familje dhe komunikimin e shëndetshëm në shkollat tona.	Forumi i Gruas Elbasan Bashkia Elbasan
20	11.04.2019	Njësia Administrative Bradashesh	Takim informues mbi të drejtat e komunitetit rom, në kuadër të ditës ndërkombëtare të romëve.	Nëpunëse Gjinore / Bashkia Elbasan N/Specialist I Policimit në Komunitet / Edukator Shkolle  Punonjës social në Nj.A. Gjinar
21		Njësia Administrative	Aktivitet ndërgjegjësues me	Spektori i Mbrojtjes së Fëmijëve

	16.05.2019	Shushice	anëtarët e komunitetit të NJ.A. Shushicë, në kuadër të ditës botërore të familjes.	dhe Barazisë Gjinore/Bashkia Elbasan -Punonjës Social në Nj.A Shushicë.
22	17.04.2019	Klasa e IX e shkollës 9 vjeçare "Luigj Gurakuqi".	Takim informues me temë "Të drejtat e fëmijës, dhuna me bazë gjinore dhe trafikimi i qënieve njerëzore"	Shoqata Tjetër Vizion në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan
23	26.04.2019	Shkolla 9-vjeçare NJ.A Shushicë	Takim ndërjegjësues me djem dhe vajza për të folur mbi dhunën në familje, dhunën mes të rinjve dhe mbi ndikimin në shkolla, shoqëri dhe më gjerë.	Forumi i Gruas Elbasan Bashkia Elbasan
24	21.05.2019	1. Shkolla e Mesme "Sali Ceka" 2. Shkolla e Mesme "Ali Myftiu" 3. Shkolla 9-Vjeçare "Xhaferr Hakani"	Trajnimi i 20 të rinjve antarë të grupit "Peer to Peer" për të qenë Agjentë Edukimi për Bashkëmoshatarët mbi temën e Dhunës në Familje.	Fondacioni "Ndihmë për Ballkanin", A2B Bashkia Elbasan
25	23.04.2019	Klasa e IX e shkollës 9 vjeçare "Ali Agjah"	Takim informues me temë "Të drejtat e fëmijës, dhuna me bazë gjinore dhe trafikimi i qënieve njerëzore"	Shoqata Tjetër Vizion në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan
26	27.05.2019	Lagje Nr.1 Lagje Nr.2 Lagje Nr.3 Lagje Nr.4 Lagje Nr.5 Lagje Nr.6	Takim informues me administratorët shoqërorë dhe punonjësit socialë të Njësive Administrative	Bashkia Elbasan
27	28.05.2019	Klasa e IX e shkollës 9 vjeçare "Fadil Gurmani"	Takim informues me temë "Të drejtat e fëmijës, dhuna me bazë gjinore dhe trafikimi i qënieve njerëzore"	Shoqata Tjetër Vizion në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan
28	29.05.2019	Klasa e IX e shkollës 9 vjeçare "Abdyl Paralloi"	Takim informues me temë "Të drejtat e fëmijës, dhuna me bazë gjinore dhe trafikimi i qënieve njerëzore"	Shoqata Tjetër Vizion në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan
29	31.05.2019	Nj.A Bradashesh Nj.A Shushice Nj.A Shirgjan	Takim informues me administratorët shoqërorë dhe punonjësit socialë të Njësive	Bashkia Elbasan

		Nj.A Paper Nj.A Gjergjan Nj.A Labinot Mal Nj.A Labinot Fushe Nj.A Gjinar Nj.A Tregan Nj.A Funar Nj.A Gracen Nj.A Zavaline	Administrative	
30	06.06.2019	Shkolla 9- vjeçare NJ.A Tregan, Elbasan	Takim ndërgjegjësues me të rinj, djem dhe vajza mbi paragjykimet, dhunën mes të rinjve, dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore.	Forumi i Gruas Elbasan Bashkia Elbasan
31	14.06.2019	Shkolla "Iliria" Bashkia Elbasan	Takim ndërgjegjësues për të folur mbi stereotipet e dëmshme, mentalitetit të prapambetur, dhunën në familje dhe ndikimet që ajo ka në shoqëri.	Forumi i Gruas Elbasan Bashkia Elbasan
32	14.06.2019	Fondacioni A2B, Qendra H4F.	Trajnimi TOT i 20 të Rinjve mbi "Mekanizmin e Koordinuar të Referimit për rastet e Dhunës në Familje"	Fondacioni "Ndihme për Ballkanin", A2B Nëpunësja Gjinore/Bashkia Elbasan
33	21.06.2019	Fondacioni A2B, Qendra H4F.	Trajnimi TOT i 20 të Rinjve mbi "Mekanizmin e Koordinuar të Referimit për rastet e Dhunës në Familje"	Fondacioni "Ndihme për Ballkanin", A2B Nëpunësja Gjinore/Bashkia Elbasan
34	04/04/2019 11/07/2019 16/07/2019 26/07/2019 30/07/2019 31/1/07/20	NJ.A: Labinot, Shirgjan, Tregan, Paper, Shushice Bradashesh Bashkia Elbasan	Sesione për ngritje kapaciteti me administratorët socialë, infirmierët dhe SPZ-të në njësitë administrative meqënëse janë personat e parë që presin dhe identifikojnë një rast dhune.	Forumi i Gruas Elbasan Bashkia Elbasan
35	09/07/2019	NJ.A. Shirgjan, Bashkia Elbasan	Forum në komunitet me burra dhe gra për të folur mbi barazinë gjinore, dhunën në	Forumi i Gruas Elbasan Bashkia Elbasan

			familje dhe dhunën me baze gjinore.	
36	25/07/2019	NJ.A. Tregan, Bashkia Elbasan	Forum në komunitet me burra dhe gra për të folur mbi barazinë gjinore, dhunën në familje dhe dhunën me baze gjinore.	Forumi i Gruas Elbasan Bashkia Elbasan
37	20/09/2019	Fondacioni A2B, Qendra H4F.	Takim i Grupit "Peer to Peer" prej 20 të Rinjsh, për të planifikuar temat mbi Dhunën në Familje që do të realizohen si aktivitete – takime ndërgjegjësuese me të rinjtë e shkollave "Sali Ceka" dhe "Ali Myftiu".	Fondacioni "Ndihmë për Ballkanin", A2B Nëpunësja Gjinore/Bashkia Elbasan
39	27/09/2019	Shkolla e Mesme "Sali Ceka"  Shkolla e Mesme "Ali Myftiu	Sesioni i Parë ndërgjegjësues për të Rinj mbi Dhunën në Familje	Fondacioni "Ndihmë për Ballkanin", A2B Nëpunësja Gjinore/Bashkia Elbasan
40	25.11.2019	Elbasan	16 Ditët e Aktivizmit	Bashkia Elbasan në bashkëpunim me OJF

Objekti 3.1 i strategjisë kërkon gjithashtu koordinim dhe bashkëpunim ndërmjet pushtetit vendor dhe organizatave me bazë fetare për trajnim dhe organizim të aktiviteteve të përbashkëta. Për këtë arsye Bashkia Elbasan ka qenë pjesëmarrëse dhe bashkëpunuese në aktivitetet e organizuara nga Forumi i Gruas me Komunitetet Fetare. Konkretisht përgjatë kësaj periudhe të 2019 janë organizuar 7 aktivitete të tilla.

**Tabela 3. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore në bashkëpunim me organizatat me bazë fetare.**

Nr	Data	Vendi	Tema	Organizua nga:
1	27.09.2019	Ambjentet e komunitetit fetar Ungjillor në Elbasan	Takim ndërgjegjësues me anetarë të komunitetit fetar Ungjillor në Elbasan, burra/djem dhe gra/vajza diskutuam mbi barazine gjinore, stereotipet e dëmshme dhe dhunën në familje.	Forumi i Gruas Elbasan (Aktivitetet janë pjesë e programit rajonal të BE-së dhe UN Women kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave.)
2	27.09.2019	Ambjentet e	Takim ndërgjegjësues me	Forumi i Gruas Elbasan

		komunitetit fetar Muslimam në Elbasan	vajza dhe djem nga komuniteti musliman për normat dhe stereotipet gjinore dhe si duhet t'i trajtojnë në shoqëri.	(Aktivitetet janë pjesë e programit rajonal të BE-së dhe UN Women kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave.)
3	15.10.2019	Pranë Kishës “Shën Thanasi “Elbasan.	Takim ndërgjegjësues me vajza dhe djem nga komuniteti fetar Orthodoks në Elbasan, për të folur mbi barazinë gjinore, stereotipet e dëmshme dhe dhunën me bazë gjinore.	Forumi i Gruas Elbasan (Aktivitetet janë pjesë e programit rajonal të BE-së dhe UN Women kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave.)
4	17.10.2019	Ambjentet e komunitetit fetar Katolik në Elbasan	Takim ndërgjegjësues me vajza dhe djem nga komuniteti Katolik për normat dhe stereotipet gjinore dhe si duhet t'i trajtojnë në shoqëri.	Forumi i Gruas Elbasan (Aktivitetet janë pjesë e programit rajonal të BE-së dhe UN Women kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave.)
5	21.10.2019	Ambjentet e komunitetit fetar Katolik në Elbasan,	Takim ndërgjegjësues me vajza dhe djem nga komuniteti fetar Katolik në Elbasan, për të folur mbi barazinë gjinore, stereotipet e dëmshme dhe dhunën me bazë gjinore.	Forumi i Gruas Elbasan (Aktivitetet janë pjesë e programit rajonal të BE-së dhe UN Women kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave.)
6	23.10.2019	Ambjentet e komunitetit fetar Musliman në Elbasan.	Takim ndërgjegjësues me vajza dhe djem nga komuniteti fetar Musliman në Elbasan, për të folur mbi barazinë gjinore, stereotipet e dëmshme dhe dhunën me bazë gjinore.	Forumi i Gruas Elbasan (Aktivitetet janë pjesë e programit rajonal të BE-së dhe UN Women kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave.)
7	30.10.2019	Në ambientet e Kishës Shën Piu X në Elbasan	Takim ndërgjegjësues me gra dhe vajza. Bashkëbisedim të shtruar mbi shqetësimet, nevojat dhe mundësitë për të ecur përpara	Forumi i Gruas Elbasan Kisha Shen Piu X në Elbasan

### **Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.**

Bashkia Elbasan luan një rol shumë të rëndësishëm në Mekanizimin e Referimit pranë kësaj bashkie. Kur një viktimë e dhunës në familje (*dhe kushdo që mund të raportojë dhunën në familje*) i drejtohet Bashkisë Elbasan, atëherë në bashkëpunim me Policinë nis procesi i vlerësimit të rastit të refruar i cili përfshin:

- një intervistë me viktimën,
- me abuzuesin, si dhe me anëtarë të tjerë të familjes,
- vlerësim të nivelit të dhunës,
- dokumentim të kujdesshëm të fakteve,
- shoqërimin në institucionet e shëndetit parësor (nëse është e nevojshme),
- si dhe transportimin e viktimës së dhunës në një vend të sigurt.

Koordinatorja dhe punonjësi i policisë si përfaqësuesit e ekipit ndërinstitucional përcaktojnë se cilët anëtarë të tjerë dhe cilat burime nevojiten për ndërhyrjen e parë dhe/ose të menjëhershme në vijim. Pas dhënies së ndihmës së parë viktimës së dhunës, koordinatorja e dhunës shtron rastin për shqyrtim në mbledhjen e ekipit teknik ndërdisiplinor.

Duhet theksuar se për rastet që nuk kërkojnë ndërhyrje emergjente kërkohet respektimi i vullnetit të viktimës së rritur lidhur me referimin e rastit. Këto janë rastet kur dhuna në familje ka mundësi që të trajtohet edhe pa një UM/UMM. Në punën e përditshme nuk mungojnë raste që mund/duhet të vlerësohen si të tilla kur bëhet fjalë për episode krejt rastësore dhe të shkëputura ku ‘agresiviteti’ i dhunuesit dhe lëndimi i viktimës mund të jenë pjesë e trajtimit psiko-social. Pa dyshim që për këtë kërkohet shumë seriozitet dhe kujdes me qëllim mbrojtjen e veçantë të familjes dhe të anëtarëve të saj. Në mbledhjet e mbajtura për shqyrtimin e rastit, anëtarët e ekipit teknik ndërdisiplinor hartojnë një plan të përbashkët ndërhyrjeje për zgjidhjen afatgjatë të rastit të trajtuar.

Menaxhimi i rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare në Bashkinë Elbasan kalon nëpër keto etapa:

1. Identifikimi
2. Referimi
3. Vlerësimi i plotë i rastit
4. Mbledhja e ekipit teknik ndërdisiplinor
5. Hartimi i planit individual
6. Monitorimi
7. Mbyllja e rastit

Bazuar në vlerësimin e nevojave të rasteve përgjatë vitit 2019 janë ofruar shërbime sipas të dhënave të detajuara më poshtë:

- mbështetje psiko sociale dhe emocionale: 134 raste total
- konsulencë dhe mbështetje ligjore: 82 raste
- strehim emergjent: 19 gra dhe 16 fëmijë
- transport në një vend të sigurtë: 18 raste
- mbështetje ekonomike si rast në nevojë: 17 raste
- mbështetje ekonomike për shkak të UM: 79 raste
- paketë ushqimore: 34 raste
- bonus per qera banese (sipas specifikave të rastit): 16 raste
- kujdes shëndetësor, blerje e ilaceve për nënat dhe fëmijet: 86 raste
- referim për ndjekjen e një kursi profesional: 69 raste
- punësim i rastit duke koordinuar me Zyrën Rajonale të Punësimit Elbasan: 17 raste
- rregjistrimi i fëmijëve përkatësisht në shkollë dhe çerdhe
- pagesa e çerdes: 8 fëmijë.

Gjithashtu është ofruar monitorim përmes metodave të komunikimit (telefonit, vizitës në familje, takim) për zbatimin e masave mbrojtëse të përcaktuara në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor për lëshimin e Urdhrit të Mbrojtjes (81 raste me UMM/UM')

Koordinatorja Vendore pranë bashkisë Elbasan ndan me anëtarët e MKR-së raportet dhe dokumentat zyrtare pas çdo mbledhje të përmbuajshme të GTN-së.

Ndërkohë që sistemi online REVALB, vijoi të shfaqte problematika edhe përgjatë vitit 2019, megjithëse pas ndryshimit të ligjit të dhunës në familje, ky sistem është nën process rifreskimi dhe është punuar rregullisht.

Përgjatë vitit 2019, numri i rasteve të trajtuara me sukses nga Mekanizmi i Referimit pranë Bashkisë Elbasan kapi shifrën e 60 rasteve të viktimave të dhunës në familje. Shifër kjo që vjen në rritje pas çdo viti.

Përgjatë vitit 2019, 16 ishin viktimat e dhunës në familje që përfituan dhe morën bonuse nga Bashkia Elbasan.

Bashkia Elbasan që nga viti 2010 ka të emëruar një Nëpunëse të Barazisë Gjinore që luan edhe rolin e Koordinatorës Vendore kundër dhunës në familje, e cila është Znj. Marsida Sejdini. Ndërkohë që në Planin e Mbrojtjes Sociale 2016-2020 dhe në "Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore 2018-2020" të kësaj Bashkie, ku është sugjeruar zgjerimi i "Sektorit të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore", si dhe propozimi për ndarjen e funksioneve të Nëpunës/es së Barazisë Gjinore dhe Koordinator/es Vendor/e kundër dhunës në familje, përmes emërimit të dy personave me kohë të plotë, por deri në periudhën e raportimit vazhdon e njëjta situatë.

Megjithëse nuk ka një marrëveshje formale me policinë koordinatorja e dhunës dërgon çdo muaj të dhënat përkatëse dhe raportin ecurinë e punës në GTN për çdo mbledhje. Dokumenta që faktojnë këtë bashkëpunim janë verbale e tryezave teknike, ku përfaqësuesit nga policia janë gjithmonë të pranishëm, referimet e rasteve nga policia për ndihmë e mbështetje të Bashkisë etj. Ky bashkëpunim është shumë konkret dhe domethënës në ndjekjen e problematikave të një gruaje të dhunës nga kordinatorja me SPZ-në e NJ.A përkatëse. Dokumenta që faktojnë këtë bashkëpunim janë verbale e tryezave teknike, ku përfaqësuesit nga policia janë gjithmonë të pranishëm, referimet e rasteve



Me Zyren Rajonale te Punesimit Elbasan, ka bashkëpunim të ndërsjelltë dhe konkretisht dhe janë arritur të punësohen 12 raste të grave me probleme dhune të pajisura me UMM/UM.

Bashkia Elbasan me Drejtorinë Arsimore Rajonale ka bashkëpunim në organizimin e fushatave të përbashkëta ndërgjegjësuese, në mbështetje për regjistrimin apo lëvizjen nga shkolla të fëmijëve të grave të dhunuara e të divorcuara, kur ndërrojnë banesë si dhe në pjesëmarrjen rregullisht në tryezen teknike të përfaqësuesve të DAR. Dokumenta që faktojnë këtë bashkëpunim janë verbale e tryezave teknike, ku përfaqësuesit nga janë gjithmonë të pranishëm, referimet e rasteve. Me Shërbimin Social ka bashkëpunim në pjesëmarrjen rregullisht në tryezen teknike të përfaqësuesve të këtij institucioni si dhe në pjesëmarrjen e tyre në fushata të përbashkëta ndërgjegjësuese. Dokumenta që faktojnë këtë bashkëpunim janë verbalet e tryezave teknike, ku përfaqësuesit nga policia, Shërbimi Social janë gjithmonë të pranishëm, referimet e rasteve

Përgjatë vitit 2019 GTN pranë mekanizmit të referimit bashkia Elbasan është mbledhur 19 herë në takime për referime apo diskutime të ndryshme të rasteve të paraqitura.

**Tabela 4. Numri i mbledhjeve të GTN-së në vitin 2019 në Bashkinë Elbasan**

Viti	Mbledhjet e GTN
2019	15.01.2019 Takimi i GTN-së bërthamë. Menaxhimi i një rasti me risk të lartë.
	06.02.2019 ora 10.00 Shkëmbim eksperience të antarëve të grupit teknik ndërdisiplinor të Bashkisë Elbasan me anëtarët e ekipeve teknike ndërdisiplinore të Bashkisë Belsh dhe Gramsh. Menaxhimi i rasteve të dhunës në Bashkinë Elbasan dhe ofrimi i mbështetjes nga çdo institucion sipas kompetencave dhe sfidat e çdo bashkie.
2019	26.02.2019, ora 10.00 Planifikimi dhe bashkërendimi i veprimeve për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në nivel vendor me rastin e 8 Marsit Ditës Ndërkombëtare të Gruas
2019	10.03.2019 ora 12:30 Takimi I grupit të punës për organizimit e kalendarit të aktiviteteve ndërgjegjësuese për dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje në shkollat e mesme të Nj.A. Shirgjan, Labinot Fushë, Paper, Gjinar. Grupi i punës : Nëpunëse Gjinore Bashkia Elbasan Specialistët e Policimit në Komunitet Shërbimi psikosocial në shkolla
2019	04.04.2019 Diskutim për rastet e menaxhuara të dhunës në familje përgjatë periudhës janar-mars 2019
2019	12.04.2019 Takim i ekpit teknik ndërdisiplinor bërthamë / Menaxhim rasti emergjent
	18.04.2019

	Takim i ekpit teknik ndërdisiplinar bërthamë/ Menaxhim rasti me rrisht të lartë.
2019	24.04.2019 Takim i ekpit teknik ndërdisiplinar bërthamë / Menaxhim rasti.
2019	14/05/2019 Vizitë studimore të përfaqësuesve të institucioneve përgjegjëse për luftën kundër dhunës në familje në Kosovë në Bashkinë Elbasan. Shkëmbim eksperience ndërmjet anëtarëve të ekpit teknik ndërdisiplinar të Bashkisë Elbasan dhe përfaqësuesve të Kosovës.
2019	29.05.2019  Takim i ekpit teknik ndërdisiplinar bërthamë /Menaxhim rasti me rrisht të lartë.
	12.06.2019 Takim i ekpit teknik ndërdisiplinar bërthamë /Menaxhim rasti emergjent me rrisht të lartë.
2019	28.06.2019 Diskutim për rastet e menaxhuara të dhunës në familje gjatë periudhës janar-qershor 2019
2019	08.07.2019 Takim i ekpit teknik ndërdisiplinar në kuader të projektit "Asistenca Teknike për Agjendën e Barazisë Gjimore në Shqipëri në procesin e anëtarësimit në BE" Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim"
2019	02.08.2019 Takim i ekpit teknik ndërdisiplinar bërthamë /Menaxhim rasti me rrisht të lartë.
2019	05.09.2019 Takim i ekpit teknik për planifikimin e aktiviteteve ndërgjegjëse për adresimin e çështjeve të barazisë gjimore për periudhën tetor-dhjetor 2019
2019	23.09.2019 Diskutim i rasteve të menaxhuara të dhunës në familje gjatë periudhës janar-shtator 2019
2019	22.10.2019 Takim i ekpit teknik ndërdisiplinar bërthamë /Menaxhim rasti me rrisht të lartë.
2019	1.11.2019 Planifikimi i kalendarit të aktiviteteve të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjimore.
2019	11.12.2019 Takim i ekpit teknik ndërdisiplinar bërthamë /Menaxhim rasti me rrisht të lartë.

*Burimi: Bashkia Elbasan*

Për periudhën që raportojmë Janar – Dhjetor 2019 është zhvilluar një mbledhje e KD-es në Bashkinë Elbasan.

**Tabela 5. Numri i mbledhjeve të KD-së sipas viteve në Bashkinë Elbasan**

Viti	Mbledhjet e KD
2019	<p>19.12.2019: Gjatë kësaj mbledhje u diskutua dhe u pasqyrua situata e Mekanizmit të Referimit të Bashkisë Elbasan. Rastet e ndjekura, bashkëpunimi me aktorët si dhe gjetje të tjera të dalë përgjatë vitit. Në fund u konkludua edhe me disa rekomandime si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të bëhen ndryshime ligjore lidhur me detyrimin që kanë ish bashkëshortët për pagesën e pensionit ushqimor ndaj fëmijëve, brënda e jashtë Shqipërisë. Për këtë të fundit të ratifikohen nga qeveria marrëveshje me vendet ku shqiptarët punojnë si emigrantë, kryesisht në Itali dhe Greqi.</li> <li>• Të forcohet zbatimi i ligjit që në rastet e lëshimit të UMM/UM, në vendim. Të llobohet për problemet e strehimit, qeveria qendrore të japë fonde Bashkive, për bonuse apo banesa sociale për gratë e mbijetuara nga.</li> <li>• Të ngrihen programe rehabilitimi për dhunesit të cilët në një përqindje të lartë të rasteve janë konsumues të alkoolit, kanë një personalitet të dhunshëm dhe janë të papunë e me arsim të ulët.</li> <li>• Të rritet puna ndërgjegjësuere e sensibilizuese nga gjithë institucionet e OJF-të. Veçanërisht në shkolla të bëhen aktivitete me vajzat në shkollë për të drejtat e tyre dhe për ti përgatitur si gra e nëna të ardhshme.</li> <li>• Profilet sociale të viktimave të dhunës në familje rekomandojnë ngritjen dhe fuqizimin e programeve të punësimit të viktimave me qëllim fuqizimin e tyre ekonomik.</li> </ul>

*Burimi: Burimi Bashkia Elbasan*

**Tabela. 6 Këshilli Drejtues Bashkia Elbasan 2019**

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2019
Bashkia	Janar- Korrik Qazim Sejдини Kryetar Nga Gushti Gledian Llatja Kryetar
Drejtoria e Policisë	Arjan Muco
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Ledio Sulkuqi
Prokuroria e Rrethit	Bledi Mustafaraj
Drejtoria Arsimore Rajonale	Milita Tupi
Drejtoria e Shëndetit Publik	Edri Stafa
Zyra e Përmbartimit	Merita Tirana
Prefektura	Eva Bica
Zyra Rajonale e Punësimit	Marsida Hyseni
DRSHSSH	Blerina Teta
Tjetër Vizion	Arian Cala
Word Vizion	Ilir Gjoni
Media	Fatmir Popja

**Tabela 7. GTN-ja e Bashkisë Elbasan viti 2019**

<b>Institucioni</b>	<b>Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2018</b>
Bashkia	Gledian Llatja Kryetar
Drejtoria Vendore e Policisë	Arjan Muco
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Ledio Sulkuqi
Prokuroria e Rrethit	Bledi Mustafaraj
Drejtoria Arsimore Rajonale	Milita Tupi
Drejtoria e Shëndetit Publik	Xhevair Budani
Zyra e Përmbartimit	Merita Tirana
Prefektura	Eva Bica
Kryetarët e Njësive Administrative	
Zyra e Punësimit	Marsida Hyseni
Organizata Jo qeveritare	Tjetër Vizion Arian Cala, World Vizion Ilir Gjoni
Strehëzat për viktimat e dhunës Forimi i Gruas	Dhoksi Gjoka FGE
Komunitete fetare	Agim Duka, Arben Ramkaj, Stavri Cipi, Sokil Lulgjuraj, Ilir Gjoni dhe Ardit Skilja
Dhoma e Avokatisë së Rrethit	Nuk ka përfaqësues
Media	Fatmir Popja; Besim Dybeli

**Burimi: Bashkia Elbasan**

Kërkesat për Urdhra Mbrojtje dhe Urdhra të Menjëhershëm të Mbrojtjes plotësohen vetëm nga policia.

Ndërkohë që në Strehëzën Kombëtare për Viktimat e Dhunës në Familje i ardhur nga Bashkia Elbasan është trajtuar vetëm një rast. (Rasti E.K)

**Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin etyre, përmes programeve të specializuara.**

Sipas vlerësimit të nevojave, Koordinatorja Vendore në Bashkinë Elbasan ka ofruar shërbime edhe për dhunuesit :

- Informim për respektimin e masave të caktuara në UM dhe penalitetet që sjell ligji për shkeljen e këtyre masave. 91 dhunues ( 89 burra dhe 3 gra)
- Referim pranë Studios Avokatore të Forumi i Gruas Elbasan, për mbështetje ligjore.
- Referim pranë qendrës Tjetër Vizion për ndjekjen e seancave të këshillimit për dhunuesit.
- Referim pranë Mjekut të Familjes për tu diagnostifikuar për shqetësimet shëndetësore.
- Referim pranë Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor.
- Referim pranë QFP për ndjekjen e një kursi profesional.
- Referim pranë Zyrës së Punës për t'u informuar me vendet e lira.

Rehabilitimi i dhunuesve dhe personave të dënuar njësoj si në dy vitet e fundit (2017 – 2018) zhvillohet nga Shoqata Tjetër Vizion e cila ofron shërbimin për këshillimin psiko-social të burrave dhe djemve të dhunshëm në funksion të ri-edukimit të dhunës në marrëdhëniet familjare. Edhe pse në çdo rast dhunuesit janë këshilluar nga nëpunësi gjinor të paraqiten pranë këtij shërbimi, për vitin 2019 janë trajtuar vetëm 11 raste të burrave dhunues. Këta persona që janë trajtuar përgjatë vitit 2019 janë po të njëjtët e referuar nga shoqata “Forumi i Gruas” një vit më parë të cilët kanë vijuar trajtimin. Për vitin 2019 asnjë rast i ri nuk është referuar për të marrë shërbimet e këshillimit përmes programeve të specializuara.

Nga monitorimi i implementimit të strategjisë vijon të mbetet një prej mangësive më të mëdha bashkëpunimi me shërbimin e provës. Sipas të dhënave të përfituara nuk ka një bashkëpunim apo marrëveshje me shërbimin e provës dhe të dhënat e publikuara nga shërbimi i provës nuk janë të disagreguara sipas llojit të krimit, diçka që do të lehtësonte identifikimin e rasteve të dhunës në familje që kanë marrë dënime alternative.

Në informacionin e marrë në zyrën e shërbimit të provës rezulton se për periudhën janar-dhjetor nuk është trajtuar asnjë rast i burrave dhunues.

Nga zyra e përmbarimit nuk trajtohen raste të burrave dhunues. Zyra e përmbarimit mbështet me dokumentacionin përkatës rastet kur burrat dhunues nuk paguajnë detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve të tyre. Gjithashtu ndjek rastet kur kanë kërkesë ankesa nga një grua e dhunuar në pengesat për të takuar apo marrë fëmijët e tyre. Për vitin 2019 kjo zyrë ka ndjekur ekzekutimin e çështjeve si vijon:

- Çështje me objekt Urdhër Mbrojtje për vitin 2019 është regjistruar vetëm 1, ndërkohë që të mbartura janë 4 çështje;
- Çështje me objekt pension ushqimor për vitin 2019 janë regjistruar 80, ndërkohë që të mbartura janë 1193 çështje;
- Çështje me objekt takim femije për vitin 2019 janë regjistruar 21, dhe të mbartura janë 89 çështje;

## Rekomandime

Në bazë të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Elbasanit për vitin 2019, më poshtë renditen disa rekomandime për përmirësimin e punës së funksionimit të Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Elbasan dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ (2016-2020), kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

- Ndjekje me përpikmëri të vendimeve të gjykatës për plotësimin e detyrimeve ndaj një gruaje të dhunuar.

- Të nxitet nga ana e shoqërisë civile dhe të merren masa për vendosjen e shërbimit të rehabilitimit në vendimet e gjykatës proces ky që duhet ndjekur nga përpjekje të të gjithë aktorëve të përfshirë për t'u materializuar.
- Është e nevojshme gjetja e mundësive për ngritjen e kapaciteteve për një qendër rehabilitimi për rastet e dhunës në familje me qëndrim afatgjatë.
- Ndjekja deri në fund e procesit, qoftë për referimin por edhe për rehabilitimin dhe monitorimin e viktimave të dhunës në familje.
- Të rriten kapacitetet e punonjësve të të gjitha institucioneve anëtarë të GTN-së, të përfshirë në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, përmes trajnimeve për të menaxhuar me efikasitet rastet që paraqiten. (*Identifikimin e hershëm; Te kuptuarit e njëjtë të rrishtut dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje*)
- Nxitja e të gjithë aktorëve pjesë e Mekanizmit që të jenë prezent në çdo mbledhje që organizohet nga GTN e bashkisë Elbasan.
- Bashkia Elbasan duhet të alokojë fonde për fletëpalosje apo materiale të tjera ndërgjegjësuese.
- Shtimi i burimeve financiare dhe njerëzore për të përballuar volumin e punës, duke qenë se përgjegjësitë dhe shërbimet për viktimat e dhunës me bazë gjinore janë shtuar. Koordinatorja vendore kundër dhunës në familje duhet të ushtrojë vetëm detyrat që kjo detyrë paracakton me ligj.
- Të krijohen mundësitë për punësimin e viktimave të dhunës në familje.
- Të ngrihen programe rehabilitimi për dhunesit.
- Mbështetje për integrimin dhe fuqizimin e grave (viktima të dhunës në familje), kredi të vogla, strehi, start ups për bizneset etj.
- Të shikohet me përparësi ngritja e strukturave për plotësimin e objektivit të tretë të strategjisë kombëtare.